



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
QENDRA E KARRIERËS DHE ALUMNI

PANAIRI VII I KARRIERËS



RAPORT, 2022

Përgatitur nga:

Dritan LAÇI

Kordinator i Qendrës së Karrierës dhe Alumni

RAPORT

PANAIRI VII I KARRIERËS

08 QERSHOR, 2022

Përmbajtja

1. Hyrje	4
2. Qendra e Karrierës dhe Alumni.....	5
3. Metoda dhe Materjalet.....	6
4. Ceremonia e hapjes së Panairit të Karrierës	9
5. Pjesëmarja në panair	12
6. Rezultat.....	17
7. Konkluzione.	18

1. Hyrje

Pjesë e vizionit të Universitetit Bujqësor të Tiranës është edukimi universitar, pasuniversitar, kërkimi dhe trajnimi për përgatitjen profesionale të specialistëve të fushës së bujqësisë, të ushqimit dhe të mjedisit. Në këtë kuadër nevoja e ndërmarrjes së inicjativave që përafrojnë kapacitetet me edukimin e duhur profesional të studenteveve sipërmarrjet, organizatat dhe institucionet publike që janë të lidhura me fushën e bujqësisë, ushqimit dhe të mjedisit, është një nevojë e padiskutueshme. Në këtë linjë, Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT), nëpërmjet Qendrës së Karrierës dhe Alumni(QKA), në ambjentet e Fakultetit të Ekonomisë & Agrobiznesit dhe Fakultetit të Bujqësisë & Mjedisit, në datën 08 Qershor 2022, organizoi Panairin e VII të Karrierës.

Tashmë Panairi i Karrierës pranë UBT është shndërruar në një traditë të suksesshme, pasi ai organizohet për të shtatin vit radhasi.

Ky event përfaqëson një mundësi të shkëlqyer ndërveprimi midis universitetit, institucioneve publike, sipërmarrjeve si dhe organizatave të profileve të ndryshme në të gjithë vëndin. Në këtë linjë, synimi është që nëpërmjet këtij organizimi të krijohet mundësi dhe lehtësohen kontaktet direkte të punëdhënësit me punëmarrësit e tyre potencial, dhe jo vetëm.

Organizimi i përvitshëm i Panairit të Karrierës, krijon mundësi shkëmbimi, krijimit të urave të komunikimit dhe të marrëveshjeve bashkëpunuese midis akademisë dhe shumë aktorëve të tjerë të shoqërisë.

Ndaj, duhet të besojmë fort se ky event shërben dhe do të shërbejë si një platformë e suksesshme në funksion të adresimit të objektivave të mëposhtme:

1. Krijimin e një hapësire për të përafroar ofertën dhe kërkesën, duke shërbyer kështu si një dritare e rëndësishme komunikimi midis punëdhënësit siç janë institucionet publike, sipërmarrja private dhe organizata të ndryshme dhe punëmarrësit që janë studentët e UBT.

2. Të shërbejë si një mundësi për studentët UBT, me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, pranë institucioneve publike, sipërmarrjeve private dhe organizatave në funksion të realizimit të praktikave profesionale.
3. Të shërbejë si një mundësi nxitëse në funksion të arritjes së marrëveshjeve bashkëpunuese midis Universitetit dhe aktorëve të rëndësishëm në tregun e punës.
4. Të shërbejë si një mundësi e rëndësishme për të absorbuar një *feedback* nga ana e aktorëve të tregut të punës me synimin e përmirësimit të kurrikulës së studimeve në UBT.
5. Të shërbejë si një mundësi e shkëlqyer promovimi për institucionet publike, sipërmarrjeve si dhe organizatave të ndryshme.

2. Qendra e Karrierës dhe Alumni

Gjykohet si e domosdoshme ekzistenca e një strukture pranë çdo universiteti, qëllimi kryesorë i së cilës është që të shërbejë si një kordinues apo hallkë ndërmjetëse, e formësimit teorik dhe praktik të studentëve, nga njëra anë, dhe facilitimit të përballjes me tregun e punës, nga ana tjetër. Ndaj, që nga viti 2013, Qendra Karrierës & Alumni (QKA) është pjesë e strukturave të UBT. Kjo qendër është pjesë e ekipit të Drejtorisë të Shërbimeve Mësimore dhe Studentëve.

Qëllimi kryesor i QKA është të informojë dhe të orientojë maturantët për të aplikuar në programet e studimeve që UBT ofron, studentët e UBT gjatë dhe mbas studimeve të tyre. Në këtë linjë, në funksion të paraprirjes së një karriere të suksesshme, QKA krijon mundësi për realizimin e praktikave, trajnime të ndryshme, pjesmarrje në konferenca, workshop, seminare, faciliton kontaktin me tregun e punës si edhe gjurmimin e ecurisë së tyre të mëtejshme.

Operacionalizimi i mëtejshëm i këtij qëllimi, ofron një sërë funksionesh kryesore mbi të cilat punon ekipi i QKA. Kështu, disa nga funksionet e QKA janë:

1. Të bashkëpunojë me zyrat e karrierës në fakultete në funksion të:
 - a. Mbledhjes së të dhënave për studentët të cilët janë në vitet e fundit të studimeve (niveli Bachelor, MP dhe MSc). Këto të dhëna do të shërbejnë si një input i rëndësishëm për krijimin e një database.

- b. Evidentimi i dhe mbledhja e CV-ve më të mirë
 - c. Krijimi i infrastrukturës së duhur në funksion të realizimit të praktikave profesionale, pjesëmarrje në trajnime të ndryshme etj.
2. Bashkëpunimi me stafin akademik, kryesisht me pedagogët e modulit Menaxhim Karriere.
 3. Krijimi dhe mbajtja e kontakteve me institucione publike, sipërmarrjen dhe organizata të tjera.
 4. Organizimi i Panaireve në bashkëpunim me strukturat e UBT

Është e natyrshme që bazuar edhe në qëllimin kryesorë të saj, organizimi i Panaireve është dhe duhet të jetë një nga funksionet rëndësishme të QKA. Është shumë e rëndësishme të theksojmë faktin se panairi përbën një organizim jashtëzakonisht shumë jetësorë për të krijuar një hapësirë në të cilën, ndër të tjera, punëmarrësi (studentët e UBT) dhe punëdhënësi kontaktojnë fizikisht mes tyre. Kështu, panairi shërben si një pikë kontakti e ofertës dhe kërkesës së tregut të punës. Ndaj, mund të themi se organizimi i përvitshëm i këtij event, përbën padyshim një nga funksionet më të domosdoshme të QKA.

3. Metodatat dhe materialet

Në funksion të organizimit të panairit, sigurisht kërkohet një sinergji mes strukturave të ndryshme. Kështu, Qendra Karrierës & Alumni, nën drejtimin e Rektoratit, Dekanatit, dhe në bashkëpunim me Zyra e Kancelarit, Pedagogët e modulit “Menaxhim Karriere”, Zyrat e Karrierës së Studentëve, Zyra e marrëdhënieve me Biznesin si edhe Forumi Ekonomik Studentor, në mënyrë të suksesshme organizuan në dt. 08 Qershor, Panairin e VII të Karrierës, në ambientet e kampusit të UBT.

Në këtë kuadër, QKA në bashkëpunim të plotë me aktorët dhe strukturat e sipër- përmendura të UBT, ndërmori të gjitha masat e nevojshme në funksion të zhvillimit të Panairit. Kështu, Matrica në Tabela 1, si më mëposhte përmban të gjitha aktivitetet e realizuara, strukturat dhe roli i tyre lidhur me secilin aktivitet specifik deri në ditën e organizimit të Panairit.

Në tabelën 1, krahas paraqitjes së njësive dhe aktiviteteve, është përcaktuar edhe roli i tyre lidhur me secilin aktivitet. Kështu, të gjitha njësitë e sipërpërmendura lidhur me aktivitetet, mund të kenë rol përgjegjësi, i informuar apo kordinues.

Përgjegjës për aktivitetin, për të cilin është ngarkuar sipas tabelës, konsiderohet njësia që përkujdeset për outputin ose rezultatin e këtij aktiviteti. Më tej, ashtu siç edhe është paraqitur në Tabelën 1, njësitë janë edhe në rolin e të informuarit lidhur me ecurinë e një aktiviteti si edhe kordinues të aktiviteteve për të cilat mund të jenë përgjegjës të tjera njësi.

Në funksion të paraprijës të realizimit me saktësi dhe në kohë të aktiviteteve të listuara në matricën e aktiviteteve, është hartuar edhe grafiku GANTTI punës (shih Tabela 2). Ky grafik pune, përmban të gjitha aktivitetet, në funksion të organizimit të Panairit dhe kohën (në ditë) respektive të realizimit të tyre.

Tabela 1: Matrica e aktiviteteteve të Panairit të VII të Karrierës

ORGANIZMI I PANAIRIT TË VII TË KARRIERËS DHE NJESITE PËRGJEGJESE							
Nr	AKTIVITETET	NJESITE E NGARKUARA					
		Rektorati	Dekanet e Fakulteteve	QKA	ZKS	Administrata	ZYRA IT
1	Nxjerrja e urdhërit për organizimin e Panairit	P					
2	Informimi elektronikisht i Pedagogëve dhe studentet si dhe afishimi i posterave informues ne godinat e UBT, QKA_Media Sociale			P	P		
3	Njoftimi në Web-UBT			K			P
4	Përpilim i broshures dhe fletepalosjeve informative elektronike & të printuar.			P			
5	Sigurim pjesmarrje në panair të Siper marrjeve, Institucioneve dhe Organizatave te ndryshme	I	P	P	P		
6	Perpilim të ftesave elektronike & printuara	I		P	P		
7	Ftesa për përfaqësues të Ministrive, Ambasadeve., NGO etj.	I		P			
8	Angazhim AKTIV i studentëve në organizimin e Panairit			P			
9	Njoftimi i mediave për zhvillimin e panairit	I		P	P		
10	Axhenda (Shqip dhe Anglisht)	I		P	P		
11	Prodhim i <i>Badge</i> për pjesmarrësit ne Panair			K	P		
12	Perpilim i listes se bizneseve per Çertifikate Mirënjohje	I		P	P		
13	Lista e bizneseve, institucioneve, NGO etj., per marrëveshje	I		P	P		
14	Promovimi i panairit në emisione mediatike	I	K	P	P		
15	Infrastruktura e panairit: Vendosja e tendave në datë 07.06.2022	I		K		(Zyra e sherbimeve)	
16	Infrastruktura e panairit: Vendosja e tavolinave, Postera, Banera në datë 07.06.2022	I		K		(Kancelar FEA dhe FBM); (Zyra e sherbimeve)	
17	Organizimi i Ceremonise së hapjes së Panairit përballë FEA, Fonia, Laptop, Projektor, PPT, PREZI)			P	(Pergj. ZKS FEA)	(Kancelar FEA)	
18	Fjala e çeljes se Panairit nga Përgjegjësi ZKS			Dritan Laçi			
19	Fjala Pershendetëse e Rektorit	Prof. Fatbardh Sallaku					
19	Vlerësimi I organizimit nga ana e pjesmarresve ne panair			K	Përgjegjësit e ZKS në të gjithë Fakultetet		

Shënim:P= Përgjegjes per outputin e aktivitetit; I= i informuar per realizimin e aktivitetit; K= Koordinues per realizimin e aktivitetit;

4. Cermonia e hapjes së panairit të karrierës

Në funksion të një gjithëpërfshirje dhe një larmishmërie të ditës së panairit, pjesë e axhendës ishte edhe cermonia e hapjes në oborrin e Fakultetit të Ekonomisë Agrare. Në këtë ceremoni, ishin pjesëmarrës të shumtë, si të ftuar, përfaqësues të institucioneve të rëndësishme publike, sipërmarrëse dhe organizatave të ndryshme, pedagogë të UBT, studentë etj. Figura 1 paraqet axhendet e ceremonies.

Figure 1. Axhenda e ceremonise.



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
QËNDRA E KARRIËRËS DHE ALUMNI

Z/Znj _____

Kam kënaqësinë t'ju ftoj të merrni pjesë në PANAIRIN E KARRIËRËS, që organizohet nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, më datë

08 Qershor 2022, në mjediset e Kampusit të UBT.

Ky event përfaqëson një mundësi të shkëlqyer lidhjeje midis universitetit, institucioneve publike, bizneseve si dhe organizatave të profileve të ndryshme në të gjithë vendin. Ne besojmë plotësisht se ky aktivitet krijon mundësi fantastike dhe lehtëson kontaktet direkte të punëdhënësit me punëmarrësit potencialë.

Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen Tuaj para datës 02.06.2022.
Për çdo informacion të mëtejshëm, jeni të lutur të na kontaktoni në: karriera@ubt.edu.al

Sinqerisht,
Rektori
Prof. Dr. Fatbardh Sallaku

PROGRAMI

09:30-10:00 Pritja e të ftuarve

10:00-10:10 Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU,
Rektor i UBT-së

10:10-10:30 Fjala përshëndetëse e të ftuarve

10:30-10:45 Firmosja e memorandumit të bashkëpunimit midis UBT dhe Sipermarketeve

10:45-11:30 Vizitë në stendat e pjesëmarrësve

11:30-13:00 Simpozium: Rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet UBT dhe aktoreve të tregut.
Salla "Luce Agraja"

11:30-13:00 Simpozium: E ardhmja e rinisë dhe bujqësia Shqiptare; Rritja e aftësive të studentëve për nevojat e tregut.
Salla "Behar Male".

13:00-14:00 Koktail

Diskutimet mbi nevojën e thellimit të bashkëpunimit të mëtejshëm midis Universitetit dhe institucioneve publike, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme mbizotëruan gjatë këtij organizmi. Për më tepër, ashtu siç edhe ishte parashikuar në axhendë, gjatë prezantimeve të tyre sipërmarrjet e ndryshme propozuan në mënyrë konkrete nevojat e tyre dhe mundësitë që UBT të kontribuojë si edhe mundësitë që ata ofrojnë për praktikantët profesionalë dhe punësimin për studentët e UBT.

Në Tabelën 3, paraqiten të ftuarit që mbajtën fjalim, dhe në Tabelën 4 listohen pjesëmarrësit në panair që prezantuan shkurtimisht profilin e tyre gjatë cermonisë.

Tabela 3: Fjalime të mbajtura nga të ftuarit gjatë cermonisë.

Të ftuar	Institucioni
Prof. Dr. Fatbardh Sallaku	Rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës
Znj. Frida Krifca	Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Z. Artur Kala	Drejtor i Agjensisë Kombëtare të Pyjeve
Z. Marin Mema	Anëtar i Bordit të Administrimit, gazetar
Z. Sokol AVXHIU	Ekspert i Risi Albania

Tabela 4: Lista e sipërmarrjeve, që përshëndetën gjatë cermonisë së hapjes.

Nr.	Sipërmarrja
1	Kantina “DUKA”
2	Agrokoni
3	NOA
4	ATLAS sha

Në fakt, dita e panairit përfaqëson vetëm një moment të caktuar në kohë të një bashkëpunimi të vazhdueshëm midis UBT dhe shumë aktorëve të tregut të punës. Kështu që, pjesë shume e rëndësishme e axhendës së Panairit, është konkretizimi i bashkëpunimit midis UBT dhe sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme. Në këtë kuadër, gjatëceremonisë, u nënshkruan 4 marrëveshje bashkëpunimi (shih Tabela 5), të cilat do të paraprijnë një bashkëpunimin mes palëve.

Tabela 5: Lista e sipërmarrje dhe organizatave të cilat nënshkruan marrëveshje bahskëpunimi me UBT.

Nr.	Sipermarrja / Organizata
1	RisiAlbania
2	Austia Premix AP
3	AZ Group

Përgjatë ceremonisë është organizuar një shorten ë të cilin morën pjesë 8 kompani të cilat dhuruan pjesëmarrësve në sallë, kryesisht studentë, dhurata pjesë e produkteve të tyre (shiko Tabela 6).

Tabela 6: Lista e kompanive që morën pjesë në shorte

Nr.	Kompania
1	NOA
2	Royal Cannine
3	Kantina Faba
4	Uji Ljathiza
5	Kantina Duka
6	Fabrika e Vajit Tre Miqte
7	Bletari Miraka
8	HAKO

5. Pjesëmarrja në panair

Aktiviteti i panairit u mbajt në datë 8 Qershor, 2022, duke nisur nga ora 09:30 dhe vijoi në një hark kohorë prej 5 orësh (deri në 14:30). Në këtë panair morën pjesë mbi 60 sipërmarrje, organizata dhe institucione publike.

Është me rëndësi të evidentojmë faktin, se pjesëmarrja ishte e larmishme. Me standin e tyre u prezantuan Fakultetet e UBT.

Tabela 7: Lista e sipërmarrjeve dhe organizatave pjesëmarrëse në Panair

Nr.	Bizneset / Organizatat pjesëmarrëse
1	Noa sha
2	Njoftime.com
3	Deloitte Albania
4	Zyre Kontabiliteti AKH
5	Megatek
6	Posta TNT Group
7	Kredo Finance
8	Raiffeisen Bank
9	ProCredit Bank
10	Era Real Estate
11	Global Reklama
12	British Amerikan Tobacco
13	Interest Motivation Power
14	BKT
15	Agrokoni
16	DM Consulting Services
17	MBM Company
18	AlbInspekt
19	AKZM
20	AKP
21	Studio Projektimi TODE
22	Kompania Erald Sh.P.K
23	Gjedra sh.p.k
24	Albgarden sh.p.k
25	Bashkia Tirane
26	Blue Filters Albania
27	Austria Praemix (AP)
28	Austrian Institute of Excellence (AIEEx)
29	Agrimatko
30	Gem Chimica Balkan

31	Albanian Investment Development Agency
32	Alba Seed
33	Bio Inspecta
34	Tirana Food Cosulting
35	Pets & Partners
36	Vet Hospital
37	Zepa
38	Kantina Duka
39	Bletari Miraka
40	Pulari Tik-Tik
41	Pajisje Laboratorike
42	Shoqata Shpendrritesve
43	Lajthiza
44	Le Spot Group
45	Inka
46	Pulari Savio
47	Royal Cannine
48	AKVMB,
49	Project of Food Safety
50	AKU
51	RisiAlbania
52	Bonum shpk
53	Cibus shpk
54	Miqesia
55	Krako
56	Miell Tirana (Prima)
57	Miell Diamond
58	EnoFama
59	DuaPune.al
60	Projekti Pema
61	RisiAlbania

Mbas ceremonisë hapëse, fjalës së rektorit, përshëndetjeve për zhvillimin e këtij aktiviteti dhe firmosjes së marrëveshjeve me biznesin, u zhvillua një tur duke takuar dhe falenderuar të gjithë bizneset pjesëmarrëse në standat e tyre.

Foto. Foto nga ceremonia hapjes dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit.





Një pjesë shumë e rëndësishme ishte pjesa e dytë e Panairit të Karrierës e cila ishte e organizuar në dy seksione. Sesioni parë me temë UBT dhe aktoret e biznesit bujqësor u organizua në sallën Luce Agraja. Në këtë sesion morren pjesë të gjithë operatorët e biznesit bujqësor por dhe jo vetëm që ishin pjesëmarrës në panair. Moderuesit e këtij takimi ishin rektori Prof. Fatbardh Sallaku dhe Dr. Shpresim Domi.

Foto: Foto nga sesioni UBT dhe aktorët e biznesit bujqësor.



Sesioni dytë, i cili u zhvillua paralelisht me sesionin e sipërpërmendur, titullohej “E ardhmja e rinisë dhe bujqësia shqiptare”. Te ftuar për këtë seksion ishin z. Artur Kala (Drejtor i Agjencise Kombëtare të Pyjeve), z. Sokol Avxhiu (ekspert në këshillim karriere) dhe z. Marin Mema (antar I bordit të administrimit UBT, gazetar). Pjesë e rëndësishme e këtij sesioni ishte “Rritja e aftësive të studentëve për nevojat e tregut”.

Foto: Sesioni dytë “E ardhmja e rinisë dhe bujqësia shqiptare”.



6. Rezultate

Në përfundim të Panairit të VII të Karrierës, një sërë rezultatesh mund të evidentohen. Kështu, si rezultat i një pune në ekip e kordinuar nga QKA, janë ftuar për pjesëmarrje aktive me standë në Panair një numër përreth 110 sipërmarrje, organizata të profileve të ndryshme dhe institucione publike. Për më tepër, janë shpërndarë ftesa drejtuar Ministrive, Ambasadorëve, Drejtues Bashkie dhe insitucioneve të tjera Publike dhe Sipërmarrjeve private.

Në kuadër të përafrimit të UBT me sipërmarrjen private dhe organizatat u nënshkruan 3 marrëveshje bashkëpunimi. Për më tepër, në funksion të shprehjes së një vlerësimi të mbështetjes së vazhdueshme ndaj UBT nga ana e sipërmarrjeve private dhe organizatave, u shpërndanë edhe çertifikata mirënjohje.

Është plotësisht e nevojshme që aktori kryesorë, studentët, të ishte në qendër të vëmendjes. Në këtë kuadër, studentët janë nxitur dhe vlerësuar për mënyrën e prezantimit të tyre gjatë panairit, nëpërmjet paraqitjes së CV-ve të tyre. Për këtë, një numër prej 4 çertifikatash janë dhënë studentëve që paraqitën CV më të mirë.

Një angazhim i tillë për organizimin e Panairit të Katërt të Karrierës, është plotësisht i justifikuar, pasi janë të pa diskutueshëm avantazhet në favor të Universitetit dhe pjesëmarrësve.

Gjithsesi, për të evidentuar disa tregues specifikë, në funksion të vlerësimit të aktivitetit të Panairit, për të gjithë pjesëmarrësit, sipërmarrjet dhe organizatat, u krijua mundësia që nëpërmjet një formulari të jepnin vlerësimin e tyre. Nëpërmjet këtij formulari synohej absorbimi i një feedbacku nga ana e pjesëmarrësve lidhur me aspekte të rëndësishme. Gjithsesi, nga 61 pjesëmarrës vetëm 23 prej tyre dhanë një feedback, duke plotësuar formularin.

Panairi është pasqyruar nga disa media si A1 Report, Top-Channel, Scan Tv dhe TVSH.

7. Konkluzione

Është e padiskutueshme që kontributi i universitetit është jo vetëm absorbimi i maturantëve, edukimi, trajnimi i tyre gjatë viteve të studimeve të cikleve të ndryshme që ofron, por gjithashtu është shume e rëndësishme që të sigurojë lehtësimin e daljes së tyre në tregun e punës. Në këtë linjë, UBT ka krijuar QKA ku ndër objektivat e së cilës është pikërisht ndërlidhja e Universitetit me tregun e punës.

Kështu që, padyshim organizimi i eventeve të cilët adresojnë këtë problematikë, janë plotësisht të nevojshme dhe të justifikuara. Ndaj, në funksion të këtij synimi, pranë ambjenteve të kampusit të UBT, u organizua edhe Panairi i VII i Karrierës.

Përgjegjësi i Qendrës së Karrierës dhe Alummi

Prof. Asoc. Dr. Dritan LAÇI

